



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2165, datë 12.10.2012

Për

“Për disa shtesa në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimit (Kontratë Tip) për Shërbimin Akses në Internet, të miratuara nga AKEP”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 12.10.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Propozim për disa shtesa në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimit (Kontratë Tip) për Shërbimin Akses në Internet, të miratuara nga AKEP”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 99, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (**Rregullorja e Brendshme**);

3. Aktet administrative në fuqi (Vendimet e Këshillit Drejtues) të nxjerra nga AKEP për miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) për Shërbimin Akses në Internet;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i praktikës dokumentare mbi çështjen, të përbërë nga:

1. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**) ;
2. Projektvendim i KD të AKEP për “*Për disa shtesa në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) për Shërbimin Akses në Internet, të miratuara nga AKEP*” (**Projektvendimi**);

si dhe, diskutimeve në mbledhje dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Me akte administrative individuale (Vendime të Këshillit Drejtues”, AKEP në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 99 të ligjit nr. 9918 dhe akteve normative të nxjerra prej tij në mbështetje të shkronjës p) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, ka miratuar Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) për Shërbimin Akses në Internet, të hartuara nga sipërmarrësit e rregjistruar sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.
2. Me qëllim mbrojtjen e interesave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, çka përbën dhe një objektiv rregullator të sanksionuar në nenin 7 të ligjit nr. 9918, Drejtoria e Rregullimit Ekonomik dhe Drejtoria e Rregullimit Teknik propozojnë përfshirjen e disa detyrimeve për ofruesit e shërbimit të aksesit në Internet, në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit dhe në kontratat që këta sipërmarrës lidhin me pajtimtarët. Detyrimet shtesë kanë lidhje me cilësinë e shërbimit të Internetit dhe synojnë rritjen e transparencës së ofrimit të këtij shërbimi për përdoruesit fundorë. Detyrimet shtesë të propozuara konsistojnë në shtesat e përshkruara në pikat në vijim 3-4.
3. Në nenin “*Detyrimet – Operatori detyrohet*”, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) për Shërbimin Akses në Internet, të shtohet një dispozitë e cila të sanksinojë detyrimin e operatorit për vendosjen e një Testeri në faqen kryesore Eeb të çdo sipërmarrësi që ofron këtë shërbim, i cili do t’i mundësojë pajtimtarëve kontrollin e shpejtësisë së kontraktuar për blerjen e shërbimit të Internetit. Shtesa e propozuar ka këtë përmbajtje:

Operatori ka detyrim që në faqen kryesore të Website zyrtar të tij të ofrojë një instrument matje të shpejtësisë të aksesit në Internet për pajtimtarët e vet. Matesi i shpejtësisë ofron mundësinë për të matur të paktën:

1. *download speed (shpejtësinë e shkarkimit) në Mbps ose Kbps*
2. *upload speed (shpejtësinë e ngarkimit) në Mbps ose Kbps*

3.latency (vonesën e lidhjes) ne milisekonda

4. Ofruesit e shërbimit të aksesit në Internet do të përfshijnë në Nën Aneks 1 të kontratave disa parametra cilësorë teknike dhe administrativë, të tillë si:
 - a. *Parametra cilësorë teknike*
 1. *shpejtësia e transmetimit të të dhënave- kontratat do të specifikojë shpejtësitë nominale/maksimale të transmetimit të të dhënave dhe shpejtësinë minimale të garantuar të tyre. Nëse ofruesi nuk siguron një shpejtësi minimale të garantuar, atëherë ky ofrues do të vendosë këtë në mënyrë eksplicite në kontratë. Shumica e ofruesve të shërbimit të aksesit në Internet janë të llojit përpjekje më e mirë, ku cilësia e tyre varet në masë të madhe nga mënyra se si ofruesit e planifikojnë rrjetin e tyre*
 2. *vonesa në transmetim, nëse ofruesi siguron një vlerë te caktuar;*
 3. *devijimi në vonesën në transmetim, nëse ofruesi siguron një vlerë te caktuar*
 4. *norma e humbjes së paketave, nëse ofruesi siguron një vlerë te caktuar*
 - b. *Parametra cilësorë administrativë*
 1. *koha për realizimin e lidhjes së aksesit në Internet, e shprehur në ditë kalendarike;*
 2. *koha e riparimit të defekteve, e shprehur në orë;*
 3. *koha e zgjidhjes së ankesave të përdoruesve, e shprehur në orë.*
5. Shtesat e propozuara janë hartuar në zbatim të kuadrit ligjor si dhe referuar praktikave më të mira ndërkombëtare për këtë qëllim, si dhe dukshëm vendos një raport më të drejtë dhe të balancuar midis kushteve të cilësisë së shërbimit të kontraktuar dhe atyre që realisht pajtimtari blen nga sipërmarrësi.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme, në zbatim të pikës 5 të nenit 99 të ligjit nr. 9918,

V E N D O S :

1. Miratimin e shtesës në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) për Shërbimin Akses në Internet, të miratuara nga AKEP, sipas pikave më poshtë:

1.1 Tek Detyrimet e Operatorit të shtohet detyrimi i mëposhtëm:

Operatori ka detyrim që në faqen kryesore te website zyrtar të tij të ofrojë nje instrument matje te shpejtësise „ aksesit në Internet për pajtimtarët e vet. Matesi i shpejtesise ofron mundesine per te matur të paktën:

1. *download speed (shpejtesinë e shkarkimit) në Mbps ose Kbps.*
2. *upload speed (shpejtesinë e ngarkimit) në Mbps ose Kbps.*
3. *latency (vonesën e lidhjes) ne milisekonda.*

1.2. Në Aneks 1 të përfshihen:

a. Parametra cilësorë teknike:

1. shpejtësia e transmetimit të të dhënave:

1. shpejtësia nominale/maksimale e transmetimit të të dhënave:

a. download____(kbps/Mbps);

b. upload____(kbps/Mbps).

2. shpejtësia minimale e garantuar e transmetimit të të dhënave:

a. Po, garantojmë minimalisht ____ (kbps/Mbps)

b. Jo, nuk garantojmë shpejtësi minimale pasi ofrimi i shërbimit bazohet në përpjekje më të mira (best effort).

2. vonesa në transmetim, nëse ofruesi siguron një vlerë të caktuar;

3. devijimi në vonesën në transmetim, nëse ofruesi siguron një vlerë të caktuar

4. norma e humbjes së paketave, nëse ofruesi siguron një vlerë të caktuar

b. Parametra cilësorë administrative:

1. koha për realizimin e lidhje së aksesit në Internet, ____ (ditë kalendarike);

2. koha e riparimit të defekteve, ____ (orë);

3. koha e zgjidhjes së ankesave të përdoruesve, ____ (orë).

2. Sipërmarrësit, të cilit me akt administrativ individual (VKD), i janë miratuar nga AKEP-i Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimit (Kontratë Tip) për Shërbimin Akses në Internet, duhet që në përputhje me përcaktimet e parashikuara në pikën 3 të nenit 99 të ligjit nr. 9918, të kryejnë ndryshimin e duhur në kontratat e lidhura me pajtimtarët e tyre.
3. Efektet ligjore të zbatimit të këtij vendimi fillojnë më datë 01. 01. 2013.
4. Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURCE